



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT**

*Adresa: Rr “Reshit Çollaku”/ Pranë ILDKP, Tiranë*

*Tel: 042 220 466 / 499 Site: [www.kkk.gov.al](http://www.kkk.gov.al) E\_mail: [kontabiliteti@kkk.gov.al](mailto:kontabiliteti@kkk.gov.al)*

**RAPORTI**

**i**

**VEPRIMTARISË**

**Viti 2023**

*Mars 2024*

## **P Ë R M B A J T J A**

### **1. Hyrje**

### **2. Aktivitetet kryesore të vitit 2023**

### **3. Informacion i detajuar mbi detyrat e realizuara në vitin 2023**

- *Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*
- *Standardet Kombëtare të Kontabilitetit*
- *Detyra të tjera:*
  - ngarkuar nga Këshilli
  - në kuadër të Planit Kombëtar të Integritimit për Raportimin Financiar në Shqipëri
  - të ndryshme administrative

### **4. Plani i punës për vitin 2024**

### **5. Çështje të tjera për rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të punës së KKK-së**

*Shtojcë A - Realizimi i treguesve të buxhetit 2023*

*Shtojcë B - Buxheti i planifikuar për vitin 2024*

*Shtojcë C – Pasqyrat financiare 2023*

## SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jomateriale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
BE	Bashkimi European
BMP	Bordi i Mbikqyrjes Publike
BSNK	Bordi i Standardeve të Kontabilitetit
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
IKM	Instituti i Kontabilistëve të Miratuar
KKK	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
NVM	Njësi ekonomike të Vogla dhe të Mesme
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin European
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

## 1. Hyrje

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, organizëm profesional, publik dhe i pavarur, ka si mision përmirësimin e vazhdueshëm të raportimit financiar të njësive ekonomike fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Ky mision, i zërthyer në objektiva të qarta, strategji të përshtatshme dhe plane pune të koordinuara, garanton transparencën dhe saktësinë e raportimeve financiare si kusht i panegociueshëm i cilësisë së vendimeve ekonomike të operatorëve të tregut.

Tre produktet kryesore që realizon KKK-ja, në kuadër të detyrave të ngarkuara nga ligji i kontabilitetit, janë:

- hartimi dhe përmirësimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit;
- përkthimi, pa ndryshime nga teksti origjinal dhe në kohë reale, i SNRF-ve;
- monitorimi i zbatueshmërisë së standardeve të raportimit financiar

Gjithashtu, si një organizëm rregullator në fushën e raportimit financiar, KKK përpunon sistemin dhe metodat kontabël. Në rast se është një nevojë e përdoruesve apo hartuesve të raporteve financiare, KKK formulon edhe udhëzimet përkatëse kontabël. KKK me ligj ka detyrimin të kontribuojë me mendime dhe sygjerime në hartimin apo ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, me propozime konkrete për kurrikulat universitare që mbulojnë fushën e kontabilitetit si dhe të publikojë materiale informuese dhe udhëzuese në zbatim të standardeve të raportimit financiar.

Viti 2023 përmbylli një angazhim shumë të rëndësishëm, rishikimin e thelluar të SKK-ve për t'i bërë ato të pajtueshme me kërkesat e SNRF për NjVM. Pas përfundimit të rishikimit të SKK-ve vazhdon puna për rishikimin edhe të Udhëzuesve në zbatim të tyre.

Paralelisht me hartimin dhe përditësimin e SKK-ve është realizuar me shumë përpikmëri dhe përkthimi i SNRF-ve dhe publikimi mbi baza vjetore i variantit të konsoliduar të SNRF-ve në gjuhën shqipe. Njësitë ekonomike të cilat kanë detyrimin të hartojnë pasqyra financiare sipas SNRF-ve kanë mundësinë (*minimalisht 1 vit para datës së zbatimit të detyrueshëm të tyre*), t'i gjejnë ato të publikuara në gjuhën shqipe në faqen zyrtare të KKK-së.

Në kuadër të procesit të integritetit, KKK-ja ka kontribuar me përgatitjen e materialeve të kërkuara nga Shërbimet e Komisionit European në lidhje me çështjet e raportimit financiar, si një çështje e rëndësishme e progres raportit për Shqipërinë.

## **1. Statusi, detyrat dhe organizimi**

### ***1.1 Statusi***

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit financohet nga buxheti i shtetit. KKK ka të drejtë të përdorë edhe të ardhurat që realizon nga punët që kryen. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Pjesë të këtij raporti ku trajtohen me hollësi edhe problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda po këtij afati.

### ***1.2 Detyrat***

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë:

- a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- b) të përpunojë një sistem kontabël, ku, përveç standardeve kombëtare të kontabilitetit, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, si dhe formatet për pasqyrat financiare;
- c) të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;
- ç) të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;
- d) të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;
- dh) të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin;
- e) të publikojë në faqen zyrtare të institucionit Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, ka të

drejtën të publikojë edhe materiale të tjera, jo të detyrueshme për zbatim, me karakter dhe qëllim informues, në funksion të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;

ë) të botojë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standarde;

f) të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar;

g) të organizojë tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës përmes përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt të SKK-ve/SNRF-ve nga njësitë ekonomike.

### ***1.3 Përbërja dhe organizimi***

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 7 anëtarë, prej të cilëve:

a) një anëtar propozohet nga organizata profesionale e auditimit ligjor;

b) një anëtar propozohet nga shoqatat profesionale të kontabilitetit;

c) një anëtar propozohet nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose njësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave;

ç) tre anëtarë propozohen nga ministria përgjegjëse për financat, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave;

d) një anëtar propozohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit mandatohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe kanë mandat 4-vjeçar. Ata mund të rimandatohen vetëm një herë me miratimin e ministrit përgjegjës për financat.

Në vjeshtën e vitit 2023 përfundoi mandati i gjashtë anëtarëve të Këshillit dhe pritet emërimi i anëtarëve të rinj nga të cilët, tre anëtarë do të jenë përfaqësues të Ministrisë së Financave, një anëtar do të jetë përfaqësues i IEKA, një anëtar do të jetë përfaqësues i shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe një anëtar do të jetë përfaqësues i Dhomave të Tregtisë ose Shoqatës së Bankave.

## 2. Detyrat e realizuara në vitin 2023

Në planin e punës, miratuar në mbledhjen e parë të vitit 2023 ishin parashikuar detyrat si më poshtë, ku në kolonën përkatëse do të jepet edhe statusi i realizimit të tyre në fund të vitit 2023.

<b>DETYRAT</b>	<b>Periudha</b>	<b>Statusi i Realizimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza e veprimtarisë 2022</li> <li>Analiza e buxhetit për vitin 2022 dhe miratimi i buxhetit 2023;</li> <li>Diskutimi dhe miratimi i Draft programit të punës për vitin 2023;</li> </ul>	Janar	Realizuar
<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i ndryshimeve të SKK 4;</li> <li>Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar të SKK 4;</li> <li>Diskutimi dhe miratimi i Kodit të Etikës;</li> </ul>	Shkurt	Realizuar
<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i ndryshimeve të SKK 5;</li> <li>Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar të SKK 5;</li> <li>Workshop me OJF-të “Për pasqyrat financiare dhe raportin e performancës së OJFve” ;</li> </ul>	Prill	Realizuar
<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i ndryshimeve të SKK 6 dhe SKK 7;</li> <li>Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar të SKK 6 dhe SKK7;</li> </ul>	Maj	Realizuar
<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i ndryshimeve të SKK 8 dhe SKK 11;</li> <li>Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar të SKK8 dhe SKK11;</li> </ul>	Maj	Realizuar
<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i ndryshimeve të SKK 3;</li> <li>Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar të SKK3;</li> <li>Miratimi dhe publikimi i variantit të konsoliduar të SNRF-ve, të publikuara deri në 2023;</li> </ul>	Qershor	Qershor

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Deklarimit të Interesave Private;</li> </ul>	Korrik	Korrik
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i ndryshimeve të SKK 9 dhe SKK 14;</li> <li>• Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar të SKK9 dhe SKK14;</li> </ul>	Tetor	Tetor
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raportim mbi mbledhjen online me përfaqësues të IASB për çështje lidhur me SKK 10;</li> <li>• Miratimi i ndryshimeve të SKK 10;</li> <li>• Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar SKK10;</li> </ul>	Nëntor	Nëntor
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i ndryshimeve të SKK 12 dhe SKK 13;</li> <li>• Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar të SKK12 dhe SKK13;</li> </ul>	Nëntor	Nëntor
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i ndryshimeve të SKK 1 dhe SKK 2;</li> <li>• Miratimi i Udhëzuesit të rishikuar të SKK 1 dhe SKK2;</li> </ul>	Nëntor	Nëntor
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi për publikim për komente i ndryshimeve të SKK 1-14</li> <li>• Miratimi për publikim i Udhëzuesve të ndryshuar të SKK1 – SKK14</li> </ul>	Dhjetor	Dhjetor

Ndër detyrat e tjera të realizuar gjatë vitit 2023 jashtë programit të miratuar kanë qenë:

- Diskutimet, përgatitja e informacionit dhe më pas raporti i përcjellë në MEF në lidhje me kërkesën e paraqitur në Këshill nga AMF në lidhje me shtyrjen e afatit të zbatimit të SNRF 17 “Kontrata e sigurimeve” parashikuar të zbatohet nga janari 2023;
- Përgatitja e raportit për prezantimin e Këshillit në takimin bilateral në Bruksel: “Screening, Chapter 6 - Company Law”;
- Mbledhja e informacionit dhe përgatitja e materialit për diskutime në Këshill në lidhje me nevojën dhe mundësinë e zbatimit të standardeve të qëndrueshmërisë në Shqipëri;



- Raportimi periodik për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me realizimin e detyrave institucionale dhe përfshirjen e tyre në kontributin për Progres Raportin për Shqipërinë;
- Të tjera administrative

Në lidhje me çështjen e zbatimit të standardeve të qëndrueshmërisë, Këshilli parashikoi edhe përgatitjen e një tryeze të rrumbullakët me këtë temë por ky aktivitet nuk u zhvillua meqenëse shoqatat e profesionit kishin marrë inicitiva të ngjashme për informim të hershëm të anëtarësive të tyre në lidhje me zhvillimet e reja në fushën e raportimit financiar në Europë dhe sidomos mes vendeve të Bashkimit Europian.

Një tjetër tryezë e rrumbullakët e parashikuar në bashkëpunim me PWC ishte ajo me temë “Zbatim i SNRF-ve në realitetin tonë”. Kjo tryezë nuk u zhvillua pasi bashkëpunëtori i Këshillit në këtë aktivitet nuk mundi të organizohet në kohën e duhur dhe për këtë arsye aktiviteti është shtyrë për t’u zhvilluar në një moment tjetër.

### **3. Informacion i detajuar mbi detyrat e realizuara**

#### ***Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar***

##### ***a) Përkthimi i SNRF-ve***

Në vitin 2023 është përkthyer, rishikuar, miratuar në KKK dhe shpallur për zbatim me Urdhër Nr. 233 dhe 233/1<sup>1</sup>, datë 05.10.2023, Urdhër Nr. 177<sup>2</sup>, datë 02.08.2023 dhe

<sup>1</sup>[https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/URDHER%20PER%20SHPALLJEN%20E%20NDRYSHIMEVE%20TE%20SNRF%207%20DHE%20SNK%207\\_Oct%202023.pdf](https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/URDHER%20PER%20SHPALLJEN%20E%20NDRYSHIMEVE%20TE%20SNRF%207%20DHE%20SNK%207_Oct%202023.pdf)

<sup>2</sup> [https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Urdheri%2014\\_Per%20ndryshimin%20e%20SNRF%2016.pdf](https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Urdheri%2014_Per%20ndryshimin%20e%20SNRF%2016.pdf)

Urdhër Nr. 232 dhe 232/1<sup>3</sup>, datë 30.10.2023 të Ministrit përgjegjës për financat, materiali i publikuara nga BSNK gjatë vitit 2023, si më poshtë:

<b>Titulli</b>	<b>Data Efektive</b>	<b>Urdhri i Ministrit të MFE-së</b>
<b>Marrëveshjet financiare me furnitorët</b> <i>Ndryshime në SNK 7 dhe IFRS 7</i>	Më 1 janar 2024	Urdhër Nr. 233 dhe 233/1, datë 05.10.2023
<b>Reforma Tatimore Ndërkombëtare—Modeli i Rregullave Shtylla e Dytë</b> <i>Ndryshime të SNK 12</i>	Më 1 janar 2023	Urdhër Nr. 177, datë 02.08.2023
<b>Mungesa e Këmbyeshmërisë (Mundësisë për Këmbim)</b> <i>Ndryshime në SNK21</i>	Më 1 janar 2025	Urdhër Nr. 232 dhe 232/1, datë 30.10.2023

***b) Përgatitja e variantit të konsoliduar të SNRF-ve***

Në datë 29 mars 2023, BSNK në përputhje me termat e kontratës, dërgoi materialin *Red Book 2023*. Përgatitja e variantit të konsoliduar 2023 të SNRF-ve në gjuhën shqipe, u bë përmes programit TRADOS nga Inspektori për SNRF-të.

Si procedurë, në variantin e konsoliduar të vitit 2023 përfshihen SNRF-të e publikuara nga BSNK deri në dhjetor të vitit 2022. Varianti i konsoliduar 2023 përfundoi brenda muajit qershor 2023 dhe u dërgua për aprovim në BSNK. Konfirmimi erdhi me email përpara mbledhjes së muajit qershor. Varianti i konsoliduar 2023 është publikuar në faqen e internetit të KKK-së.<sup>4</sup>

<sup>3</sup>[https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/URDHER%20PER%20SHPALLJEN%20E%20NDRYSHIMEVE%20TE%20SNRF%201%20DHE%20SNK%2021\\_Oct%202023.pdf](https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/URDHER%20PER%20SHPALLJEN%20E%20NDRYSHIMEVE%20TE%20SNRF%201%20DHE%20SNK%2021_Oct%202023.pdf)

<sup>4</sup> <https://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=135&gj=sh>

## *Standardet Kombëtare të Kontabilitetit*

### *a) Përditësimi i SKK -ve (2023)*

Në vitin 2022 filloi puna për përditësimin e setit të SKK-ve. Procesi i përditësimit vijoi dhe përfundoi në vitin 2023. Të gjitha standardet pësuan ndryshime në formë dhe në përmbajtje. Ndër arsyt e rëndësishme të këtij rishikimi ishin:

- periudha 8 (tetë) vjeçare e mos reflektimit të asnjë zhvillimi në fushën e raportimit financiar ndërkombëtar;
- lehtësimi i tyre duke kaluar disa paragrafë tek udhëzuesit për zbatimin e tyre por edhe lehtësimi nga kërkesa të përsëritura apo nga ndonjë kontraditë e krijuar për shkak të ndryshimeve të legjislacionit në vitet e mëpasshme;
- nevoja për rifrazime të shumë paragrafëve për të reflektuar zhvillimet dhe ndryshimet në fjalorthin teknik të raportimit financiar; si dhe
- nevoja për një rishikim nga pikëpamja gjuhësore dhe korrigjime të gabimeve drejtshkrimore.

SKK-të e përditësuara (2023) reflektojnë kërkesat e NjVM (2015) duke rritur shkallën e përputhshmërisë mes dy seteve të raportimit financiar. Gjithashtu, që SKK-të të jenë më resiliente, janë hequr të gjitha referencat ligjore, të cilat ndryshojnë më shpesh e për pasojë do kërkonin ndryshime të njëpasnjëshme edhe të SKK-ve.

Këshilli vendosi që data efektive e SKK-ve të përditësuara të jetë 1 janar 2025 dhe ato të aplikohen në prospektivë pa ndryshime të raportimeve të periudhave të mëparshme.

Më poshtë janë listuar ndryshimet më të qenësishme të bëra në secilin prej SKK-ve të përditësuara (2023).

*SKK 1 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare:*

- paragrafët 6, 28, 37, 54, 65, 75, 76, 80, 81, 82, 103, 104, 105 kanë kaluar plotësisht ose pjesërisht në Udhëzues;
- hiqen paragrafi 18 dhe 19 sepse bien në përsëritje me kërkesa të dhëna në SKK 2 dhe 9;
- hiqet paragrafi 55 sepse përsërit kërkesat e paragrafëve 42 dhe 43;
- riformulohet paragrafi 61 për të reflektuar ndryshimet e vitit 2020 të SKK 3 *Instrumentet financiare*;
- riformulohet paragrafi 66 për të reflektuar një kërkesë të SNRF për NjVM (2015), për pasojë në SKK e përditësuar shtohet kërkesa e re lidhur me “kohshmërinë” e informacionit financiar;
- riformulohet paragrafi 98 për të reflektuar një kërkesë të SNRF për NjVM (2015);
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 10.17 të SNRF për NjVM (2015);
- hiqet paragrafi 108 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 106;
- plotësohet paragrafi 113;
- hiqet paragrafi 114 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 112;
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 32.3 të SNRF për NjVM (2015);
- hiqet paragrafi 127 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 118.

*SKK 2 Paraqitja e pasqyrave financiare:*

- riformulohet paragrafi 2;
- hiqet paragrafi 37 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 38;
- riformulohet paragrafi 48 për të reflektuar një kërkesë të SNRF për NjVM (2015);
- përditësohet paragrafi 48 për të reflektuar kërkesën në paragrafin 5.4 të NjVM (2015);
- hiqet paragrafi 51 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 48;
- hiqet paragrafi 61 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 62;
- riformulohet paragrafi 76 që të reflektojë kërkesën në paragrafin 7.5 të SNRF për NjVM (2015).

*SKK 3 Instrumentet financiare:*

- riformulohet paragrafi 2;
- lehtësohet paragrafi 6 nga një kërkesë që konsiderohet e parakohshme për zhvillimet vendase;
- plotësohet paragrafi 9 për të reflektuar kërkesën 11.11 të SNRF për NjVM (2015).

*SKK 4 Inventarët:*

- riformulohet paragrafi 2;
- paragrafët 7, 8, 14, 20, 30, 32, 33 kanë kaluar plotësisht ose pjesërisht në Udhëzues;
- paragrafi 9 riformuluar për një qartësim të mëtejshëm;
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 13.11 të SNRF për NjVM (2015);
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 25.2 të SNRF për NjVM (2015);
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 13.12 të SNRF për NjVM (2015);
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 13.14 të SNRF për NjVM (2015);
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 13.15 të SNRF për NjVM (2015);
- riformuluar, shtuar dhe pakësuar paragrafi 15 për të reflektuar paragrafin 13.8 të SNRF për NjVM (2015);
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 13.18 të SNRF për NjVM (2015);
- rifrazohen paragrafi 19, 20, 21 për të lehtësuar kuptueshmërinë e tyre;
- riformulohet paragrafi 28 për të reflektuar kërkesën 27.4 të SNRF për NjVM (2015);
- shtuar paragrafë të rinj për të reflektuar kërkesat 13.20 dhe 13.21 të SNRF për NjVM (2015).

*SKK 5 Aktivët afatgjatë materiale dhe jomateriale:*

- riformulohet paragrafi 2;
- paragrafët 17, 21, 22, 33, 34, 39, 86 kanë kaluar plotësisht ose pjesërisht në Udhëzues;
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 17.11 të SNRF për NjVM (2015);
- bashkohen paragrafët 24 dhe 25 për një kuptueshmëri më të mirë;
- rifrazohet paragrafi 65 dhe 102;
- plotësohet paragrafi 76 për të reflektuar kërkesën 27.1 të SNRF për NjVM (2015);
- plotësohet paragrafi 78 për të reflektuar kërkesën 27.6 të SNRF për NjVM (2015);
- plotësohet paragrafi 104 për të reflektuar kërkesën 27.31 të SNRF për NjVM (2015);
- plotësohet paragrafi 105 për të reflektuar kërkesën 27.30 të SNRF për NjVM (2015);
- hiqet paragrafi 115 për dispozitat e mëparshme kalimtare.

*SKK 6 Provizionet, aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara:*

- riformulohet paragrafi 2;
- paragrafët 8, 9, 25, 29, 30, 31, 32, 34, 35, 36 kanë kaluar plotësisht ose pjesërisht në Udhëzues;
- hiqet paragrafi 13 sepse përsërit një nga kërkesat e paragrafit 7.

*SKK 7 Kontabilizimi i qirave:*

- riformulohet paragrafi 2;
- paragrafët 9, 10, 12 kanë kaluar plotësisht ose pjesërisht në Udhëzues;
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 20.29 të SNRF për NjVM (2015).

*SKK 8 Të ardhurat:*

- riformulohet paragrafi 2;
- paragrafi 36 ka kaluar në Udhëzues;
- rifrazohet pjesërisht paragrafi 6;
- hiqet paragrafi 8 sepse përsërit kërkesat e paragrafeve 16 dhe 21;
- hiqet paragrafi 10 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 9;

- rifrazohet paragrafi 43 për një kuptueshmëri më të mirë.

*SKK 9 Kombinimi i bizneseve dhe konsolidimi:*

- riformulohet paragrafi 2;
- paragrafi 22 ka kaluar në Udhëzues;
- plotësohet paragrafi 4 për të reflektuar kërkesën 9.1 të SNRF për NjVM (2015);
- rifrazohet paragrafi 30;
- plotësohet paragrafi 56 për të reflektuar kërkesën 9.26 të SNRF për NjVM (2015).

*SKK 10 Grantet:*

- riformulohet paragrafi 2;
- termi “Grante” zëvendësohet me termin “Grante qeveritare”;
- hiqet paragrafi 15 për dispozitat e mëparshme kalimtare.

*SKK 11 Tatimi mbi fitimin:*

- riformulohet paragrafi 2;
- hiqet paragrafi 10 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 9;
- plotësohet paragrafi 19 për të reflektuar kërkesën 29.13 të SNRF për NjVM (2015);
- plotësohet paragrafi 21 për të reflektuar kërkesën 29.25 të SNRF për NjVM (2015);
- hiqet paragrafi 36 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 35;
- plotësohet paragrafi 39 për të reflektuar kërkesën 29.39 të SNRF për NjVM (2015);
- plotësohet paragrafi 40 për të reflektuar kërkesën 29.40 të SNRF për NjVM (2015).

*SKK 12 Efektet e ndryshimeve të kurseve të këmbimit:*

- riformulohet paragrafi 2;
- hiqet paragrafi 15 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 16;
- hiqet paragrafi 17 sepse përsërit kërkesat e paragrafit 18;
- shtohen dy paragrafë të rinj që reflektojnë kërkesat në paragrafin 30.22 të SNRF për NjVM (2015);

- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 30.23 të SNRF për NjVM (2015);
- hiqen paragrafët 22-24 sepse përsërisin kërkesat e paragrafëve 29-32;
- plotësohet paragrafi 30 për të reflektuar kërkesën 30.18 të SNRF për NjVM (2015).

*SKK 13 Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare:*

- riformulohet paragrafi 2;
- paragrafët 6, 7, 18 kanë kaluar plotësisht ose pjesërisht në Udhëzues;
- korrigjohet gabimi në paragrafin 29, gërma (c.ii);
- hiqet paragrafi 33 për dispozitat e mëparshme kalimtare.

*SKK 14 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta:*

- riformulohet paragrafi 2;
- paragrafi 7 kalon pjesërisht në Udhëzues;
- plotësohet paragrafi 8 për të reflektuar kërkesën 14.4 të SNRF për NjVM (2015);
- korrigjuar referenca në paragrafin 10;
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesat në paragrafët 14.9 dhe 14.10 të SNRF për NjVM (2015);
- plotësuar paragrafi 20 për të reflektuar kërkesën 15.9 të SNRF për NjVM (2015);
- korrigjuar referenca në paragrafin 22;
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesat në paragrafët 15.14 dhe 15.15 të SNRF për NjVM (2015);
- plotësohet paragrafi 27 për të reflektuar kërkesën 14.12 të SNRF për NjVM (2015);
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 14.15 të SNRF për NjVM (2015);
- plotësohet paragrafi 30 për të reflektuar kërkesën 15.19 të SNRF për NjVM (2015);
- shtohet një paragraf i ri që reflekton kërkesën në paragrafin 15.21 të SNRF për NjVM (2015).



## *Detyra të tjera*

### ➤ **RAPORTI I VEPRIMTARISË 2022**

Raporti i veprimtarisë 2022. Në ligjin e kontabilitetit, neni 27(1) dhe 27(2) parashikohet që Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Raporti, pjesa ku trajtohen me hollësi problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike, brenda afatit të pikës 1, të këtij neni.

Raporti i veprimtarisë 2022 u miratua në Këshill për t'u dërguar, brenda të gjitha afateve, tek ministri përgjegjës për financat dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Gjithashtu raporti i veprimtarisë u publikua në faqen e internetit të KKK-së.

### ➤ **TRYEZË E RRUMBULLAKËT “RAPORTIMI FINANCIAR I OJF-ve”**

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, organizoi në datë **24 maj 2023**, një tryezë të rrumbullakët me temë “*Cilësia e raportimit financiar të OJF-ve*”. SKK për OJF-të, është publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në vitin 2016. Këshilli, në cilësinë e hartuesit të këtij standardi, vlerësoi se ishte moment i përshtatshëm që, zbatuesit e Standardit dhe përdoruesit e informacionit financiar që ky Standard siguron, të bënin një vlerësim të situatës në lidhje me cilësinë e raportimit financiar të OJF-ve. Palët e interesuara u inkurajuan për të diskutuar nëse në këto vite kishin lindur problematika të zbatimit të këtij Standardi apo nevoja të reja për raportim, në mënyrë që KKK të merrte iniciativën dhe përmes ndryshimeve në Standard apo në Udhëzues të ofronte zgjidhjet e duhura.

Morën pjesë në këtë tryezë pune profesionistë të kontabilitetit, drejtpërdrejt të angazhuar në raportimin financiar të OJF-ve me qëllim që me diskutimet e tyre të kontribuonin në evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësime të reja të Standardit për raportimin financiar të OJF-ve dhe Udhëzuesit në zbatim të tij.

Qëllimi i KKK ishte që ky aktivitet profesional të nxisë në rritjen e mëtejshme të cilësisë së raportimit financiar të OJF-vë, të cilat zhvillojnë aktivitete në fusha të ndryshme e të rëndësishme të jetës sociale dhe në proporcion me fondet që menaxhojnë, transparenca e ofruar në raportimin e tyre financiar ka interes publik.

Në përfundim të tryezës, nuk u evidentuan problematika lidhur me kontabilitetin dhe raportimin financiar të OJF-ve por diskutimet e shumta nxorrën në pah disa paqartësi apo rregullime të paqarta lidhur me aspekte fiskale, duke veçuar ato më të shprehurat:

- Të sqarohen në legjislacion rastet specifike kur OJF-të duhet (nuk duhet) të lëshojnë fatura të fiskalizuara;
- Udhëzime të qarta si përgatitet deklarata e tatimit fitimit;
- Njohja e të ardhurave;
- Raportimi i shitjes së aktiveve afatgjata;
- Raportimi i fondeve të siguruar nga OJF-të për mbështetje të pjesshme të shtresave në nevojë dhe kuotave që përballohen prej përfituesve të drejtpërdrejtë;
- Etj.

Këshilli nuk mund të ofrojë zgjidhje përsa i përket trajtime fiskale por u angazhua që këto problematika t'i përcjellë në tryezat përkatëse sa herë t'i paraqitet rasti.

### ➤ *Monitorimi i pasqyrave financiare*

#### *Gjetje nga monitorimi i pasqyrave financiare*

Të gjitha njësitë ekonomike e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshëm.

Në zbatim të kërkesës së ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 27, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet të raportojë problemet e konstatuara nga monitorimi i pasqyrave financiare në lidhje me zbatueshmërinë e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Gjatë vitit 2023 janë monitoruar pasqyrat financiare të vitit 2021&2022 . Pasqyrat financiare janë siguruar nga faqja zyrtare e QKB-së. Përzgjedhja e njësive ekonomike është bërë në mënyrë të rastësishme. Nga portali i QKB-së janë shkarkuar rreth **300 (treqind)** pasqyra financiare por janë marrë në shqyrtim vetëm **140 (njëqind e dyzet)** prej tyre,

Forma juridike e njësive ekonomike të monitoruara është:

- **103 (njëqind e tre)** njësi ekonomike – Shpk;
- **34 (tridhjetë e katër)** njësi ekonomike – Sha;
- **3 (tre)** njësi njësi ekonomike - Degë e shoqërisë së huaj

Ky klasifikim është bërë duke u bazuar në Ekstraktin Historik të subjekteve.

Nga **140 (njëqind e dyzet)** njësi të marra në shqyrtim:

- **128 (njëqind e njëzet e tetë)** njësi ekonomike kanë hartuar dhe publikuar pasqyra financiare për vitin 2021 dhe 2022;
- **5 (pesë)** njësi ekonomike, me status Aktiv prej të cilave **2 (dy)** Sha dhe **3 (tre)** Shpk, nuk kanë depozituar në QKB pasqyrat financiare vjetore, mbajtja e të cilave sipas ligjit është e detyrueshme.
- **7 (shtatë)** njësi ekonomike janë subjekte në likuidim ose kanë pezulluar aktivitetin e tyre për një kohë të pacaktuar.

Të klasifikuara sipas statusit juridik, njësitë si më lart grupohen:

	Total	SHPK	SHA	Degë e shoqërisë së huaj
Kanë publikuar Pasqyra financiare	128	95	30	3
Nuk kanë publikuar Pasqyra financiare	12	8	4	0
<b>Total njësi të monitoruara</b>	<b>140</b>	<b>103</b>	<b>34</b>	<b>3</b>

Nga **128 (njëqind e njëzet e tetë)** njësi ekonomike që kanë publikuar pasqyrat financiare:

- **20 (njëzet)** njësi ekonomike zbatojnë SNRF-të;
- **106 (njëqind e gjashtë)** njësi ekonomike zbatojnë SKK-të (1-14);
- **2 (dy)** njësi ekonomike zbatojnë SKK 15

Klasifikimi i njësive ekonomike sipas Standardeve të zbatuara është si më poshtë:

	Total	Të Mëdha	Të Mesme	Të Vogla/Mikro
SKK	106	2	27	77
SNRF	20	20	0	
SKK15	2			2
<b>Total</b>	<b>128</b>	<b>21</b>	<b>28</b>	<b>79</b>

- **2 (dy)** njësi ekonomike klasifikuar si njësi ekonomike e madhe për vitet 2020, 2021 (*Olsi shpk dhe Rozafa shpk*), kanë detyrim ligjor të zbatojnë SNRF-të për hartimin e pasqyrave financiare. Gjejmë në fakt se kanë zbatuar SKK-të.
- **9 (nëntë)** njësi ekonomike, që plotësojnë kriterin e xhiros ose të aktivitetit të njësive ekonomike të mëdha, nuk kanë dhënë në shënime numrin e të punësuarve prandaj nuk mund të përcaktohet nëse janë njësi ekonomike të mëdha apo të mesme. Në hartimin e pasqyrave kanë zbatuar SKK-të.

### **Problematika gjatë monitorimit të Pasqyrave Financiare**

Nga **128 (njëqind e njëzet e tetë)** njësi ekonomike që kanë hartuar dhe publikuar Pasqyrat Financiare rezulton se:

<b>Totali i njësive Ekonomike</b>	128
Njësi ekonomike e Madhe /Mesme	49
Njësi ekonomike e Vogël	79

Forma juridike e njësive ekonomike që kanë hartuar dhe publikuar Pasqyrat Financiare rezulton si më poshtë:

Pasqyra Financiare	Total njësi ekonomike	SHPK	SHA	Degë e shoqërisë së huaj
Njësi ekonomike e Madhe	21	9	12	
Njësi ekonomike e Mesme	28	17	9	2
Njësi ekonomike e Vogël	79	69	9	1
<b>Total</b>	<b>128</b>	<b>95</b>	<b>30</b>	<b>3</b>

- Nga **26 (njëzet e gjashtë)** njësi ekonomike të Mesme (Shpk dhe Sha), **5 (pesë)** njësi ekonomike forma juridike shpk dhe **2 (dy)** njësi ekonomike forma juridike sha, nuk kanë dhënë numrin e punonjësve për dy vite rradhazi. Prandaj nuk mund të përcaktohet nëse mund të klasifikohen apo jo njësi ekonomike e Madhe.
- Nga **78 (shtatëdhjetë e tetë)** njësi ekonomike të Vogla (Shpk dhe Sha), **19 (nëntëmbëdhjetë)** njësi ekonomike forma juridike Shpk dhe **2 (dy)** njësi ekonomike forma juridike Sha, nuk kanë dhënë numrin e punonjësve për dy vite rradhazi. Prandaj nuk mund të përcaktohet nëse mund të klasifikohen apo jo njësi ekonomike e Mesme.

Nga totali i njësive ekonomike të monitoruara, **49 (dyzet e nëntë)** njësi ekonomike janë me status njësi ekonomike e Madhe /Mesme. Sipas ligjit të kontabilitetit këto njësi ekonomike duhet të hartojnë dhe publikojnë:

- Pasqyrën e Pozicionit Financiar,
- Pasqyrën e Perfomancës (përfshirë pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse),
- Pasqyrën e Fluksit të Mjeteve Monetare,
- Pasqyrën e Ndryshimit të Kapitalit dhe
- Shënimet Shpjeguese.

Disa nga këto njësi nuk i kanë publikuar të gjitha pasqyrat financiare të kërkuara sipas ligjit.

Më poshtë tabela përmbledhëse:

Njësi ekonomike të Mëdha / Mesme	PO	JO
Pozicioni financiar	49	
Performanca	49	
Të ardhura gjithpërfshirëse	49	
Fluksi mjete monetare	47	2
Ndryshimi kapitalit	48	1

- **2 (dy)** njësi ekonomike forma juridike Shpk &Sha, nuk kanë publikuar në QKB pasqyrën e Fluksit të mjeteve monetare. Ky informacion nuk është pasqyruar as në shënimet shpjeguese.
- **1 (një)** njësi ekonomike, forma juridike Sha, nuk ka publikuar në QKB pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, por ka dhënë informacion në shënimet shpjeguese.

Nga totali i njësive ekonomike të monitoruara, **79 (shtatëdhjetë e nëntë)** njësi ekonomike janë me status njësi ekonomike e vogël. Sipas ligjit këto njësi ekonomike duhet të hartojnë dhe publikojnë Pasqyrën e pozicionit financiar, Pasqyrën e performancës dhe Shënimet shpjeguese. Disa nga këto njësi kanë hartuar dhe publikuar vullnetarisht edhe pasqyrat e tjera financiare.

Më poshtë tabela përmbledhëse:

Pasqyrat financiare	PO	JO	Vullnetarisht
Pozicioni financiar	79	0	
Perfomanca	76	3	
Të ardhura gjithpërfshirëse	76	3	
Fluksi mjeteve monetare			26
Ndryshimi i kapitalit			26

Në mënyrë vullnetare, **26 (njëzet e gjashtë)** njësi ekonomike të vogla, referuar kriterit të të ardhurave apo të aktivitetit, kanë publikuar pasqyrat: Fluksi i mjeteve monetare dhe Ndryshimi i kapitalit. Por mbetemi me rezervë në këtë përcaktim pasi **21 (njëzet e një)** nga këto njësi ekonomike nuk kanë deklaruar në shënime numrin e punonjësve kriteri i cili mund të përcaktojë që në fakt janë njësi ekonomike të mesme dhe nga deklarimet vullnetare, publikimi i pasqyrave të fluksit dhe ndryshimit të kapitalit, kthehet në deklarim të detyrueshëm.

Të gjitha njësitë ekonomike të monitoruara që kanë publikuar në QKB pasqyrat financiare, në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Njësi ekonomike të Medha / Mesme	PO	JO
Pozicioni financiar	49	
Perfomanca	49	
Të ardhura gjithëpërfshirëse	49	
Fluksi mjeteve monetare	47	2
Ndryshimi kapitalit	48	1

Njësitë ekonomike të vogla, kanë detyrim të publikojnë pasqyrën e pozicionit, pasqyrën e të ardhurave/shpenzimeve dhe shënimet shpjeguese. Plotësimi i kësaj kërkesë paraqitet si më poshtë:

Njësi ekonomike të medha / mesme	PO	JO
Pozicioni financiar	79	0
Perfomanca	76	3
Të ardhura gjithëpërfshirëse	76	3
Fluksi mjeteve monetare		
Ndryshimi kapitalit		

Kostojmë se pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse e kanë publikuar vullnetarisht 76 njësi ekonomike të vogla.

Sipas ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 23, pika 3, “Pasqyrat financiare nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare”. Nga monitorimi i 128 njësive që kanë publikuar pasqyrat financiare u konstatua se jo të gjitha njësitë ekonomike e kanë zbatuar këtë kërkesë të ligjit dhe konkretisht:

- **65 (gjashtëdhjetë e pesë)** pasqyra janë nënshkruar korrekt nga të dy autoritetet e përcaktuara në ligj;
- **2 (dy)** pasqyra janë nënshkruar vetëm nga hartuesi;
- **25 (njëzet e pesë)** pasqyra janë nënshkruar vetëm nga administratori;
- **36 (tridhjetë e gjashtë)** pasqyra nuk janë nënshkruar nga asnjë prej autoriteteve.

Në grupin e njësive ku pasqyrat janë të nënshkruara vetëm nga hartuesi, një prej tyre është njësi ekonomike e mesme. Në grupin e njësive ku pasqyrat janë të nënshkruara vetëm nga administratori **5** njësi janë të mëdha, **3** janë të mesme dhe **17** janë njësi ekonomike të vogla. Dhe pasqyrat pa asnjë nënshkrim janë të **8** njësive ekonomike të mëdha, të **11** njësive ekonomike të mesme dhe të **17** njësive ekonomike të vogla.

Sipas madhësisë	Sipas ligjit	Hartuesi i pasqyrave	Nuk ka firmë/vulë	Firmë Admin.	Totali
Njësi ekonomike Madhe	8		8	5	21
Njësi ekonomike Mesme	13	1	11	3	28
Njësi ekonomike e Vogël	44	1	17	17	79
<b>Total</b>	<b>65</b>	<b>2</b>	<b>36</b>	<b>25</b>	<b>128</b>



## Problematika të monitorimit të përmbushjes së detyrimit të Auditimit të Pasqyrave Financiare

Të gjitha njësitë ekonomike, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin Ligji Nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” mbartin detyrimin të auditohen.

Nga **128 (njëqind e njëzet e tetë)** njësi ekonomike që kanë publikuar Pasqyrat Financiare, **75 (shtatëdhjetë e pesë)** prej tyre plotësojnë kriterin për auditim të pasqyrave financiare.

Nga monitorimi rezulton se vetëm **24 (njëzet e katër)** njësi e kanë publikuar raportin e auditimit ligjor, pra vetëm 29% e njësive ekonomike që e mbartin këtë detyrim. Konstatohet se në shënimet shpjeguese të publikuara, mes **128 (njëqind e njëzet e tetë)** njësive, në **41 (dyzet e një)** raste përmendet vetëm emri i audituesit apo shoqërisë audituese por detyrimi për të dhënë informacion mbi pagesat e bëra për secilin lloj auditimi është respektuar vetëm në **2 (dy)** prej pasqyrave financiare të monitoruara.

Klasifikimi sipas madhësisë së njësive ekonomike që e plotësojnë kriterin për auditim të pasqyrave financiare si dhe shkalla e plotësimin të kërkesës në lidhje me Auditimin e tyre paraqitet si më poshtë:

	Plotësojnë kriterin për auditim	Raport auditimi	Emri audituesit	Pagesa audituesit
Njësi ekonomike madhe	21	9	15	
Njësi ekononike mesme	28	8	13	1
Njësi ekonomike vogël	26	7	13	1
<b>Total</b>	<b>75</b>	<b>24</b>	<b>41</b>	<b>2</b>

Nga **79 (shtatëdhjetë e nëntë)** njësi ekonomike të vogla, vetëm **26 (njëzet e gjashtë)** prej tyre plotësojnë kriteret e auditimit. Ndërsa **8 (tetë)** njësi ekonomike të vogla e plotësojnë këtë kriter vetëm për vitin 2021, jo për dy vite rradhazi, prandaj do të monitorohen edhe për vitin 2022 e më pas do të jepet informacion i plotë nëse e kanë përmbushur apo jo këtë detyrim ligjor.

### **Problematika gjatë monitorimit të Raporteve të tjera që shoqërojnë Pasqyrat financiare**

Njësitë ekonomike të mesme, të mëdha si dhe ato me interes publik, kur plotësojnë disa kritere shtesë, të përcaktuara në ligjin për kontabilitetin, duhet të publikojnë krahas pasqyrave financiare edhe:

- raportin e ecurisë së veprimtarisë,
- raportin jofinanciar,
- raportin e drejtimit të brendshëm si dhe
- raportin e pagesave që i'u bëhen institucioneve shtetërore.

Ndër njësitë ekonomike që kanë publikuar Pasqyrat financiare, detyrimi për të përgatitur raportet e tjera që shoqërojnë pasqyrat financiare rezulton i përmbushur si më poshtë:

Raporte që shoqërojnë Pasqyrat financiare	Njësi ekonomike që i kanë detyrim ligjor raportet	PO	JO	Njësi ekonomike që nuk e kanë detyrim ligjor raportet
Raporti ecurisë veprimtarisë	49	34	15	2
Raport jofinanciar	4	2	2	4
Raport drejtimi brendshëm	27	6	21	0
Raportimi i pagesave për inst. shtetërore	3	2	1	7

➤ Raporti i ecurisë së veprimtarisë së njësisë ekonomike

Njësitë ekonomike që e kanë detyrim ligjor publikimin e këtij raport janë njësitë e mëdha dhe të mesme ekonomike. Raporti duhet të përmbajë treguesit kryesorë të performancës financiare dhe të paraqesë një zhvillim të drejtë të njësisë ekonomike.

- **15 (pesëmbëdhjetë)** njësi ekonomike **nuk** e kanë publikuar Raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- **2 (dy)** njësi ekonomike, të klasifikuara si njësi ekonomike e vogël kanë publikuar vullnetarisht Raportin e ecurisë së veprimtarisë

➤ Raporti jofinanciar

Kanë detyrimin ligjor të publikojnë këtë raport njësitë e mëdha ekonomike të cilat janë me interes publik dhe tejkalojnë kriterin e numrit mesatar të punësuarve prej 500 vetë. Ky raport përmban:

- a) një përshkrim të shkurtër të modelit të biznesit të njësisë ekonomike;
- b) një përshkrim të politikave të ndjekura nga njësia ekonomike në lidhje me këto çështje, përfshirë zbatimin e procesit të kërkimit dhe verifikimit sistematik të saktësisë së pasqyrave financiare (due diligence);
- c) përfitimet e këtyre politikave;
- ç) riskun kryesor lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetin e shfrytëzimit të njësisë ekonomike, duke përfshirë, kur është e nevojshme, lidhjet e biznesit, produktet ose shërbimet, të cilat kanë të ngjarë të shkaktojnë ndikim të ndërsjellë dhe se si njësia ekonomike e menaxhon riskun e tyre;
- d) treguesit kryesorë të performancës jofinanciare në lidhje me biznese të veçanta.

Nga **21 (njëzet e një)** njësitë ekonomike të mëdha, **17 (shtatëmbëdhjetë)** nuk e kanë detyrim ligjor, publikimin e Raportit jofinanciar ndërsa **4 (katër)** njësitë e tjera ekonomike e kanë detyrim ligjor sepse numri i punonjësve është më i madh se 500. Mes tyre që e kanë detyrim publikimin e këtij raporti gjejmë që:

- **2 (dy)** njësi ekonomike e kanë publikuar;
- **2 (dy)** njësi ekonomike **nuk** e kanë publikuar

Në grupin e 17 njësive ekonomike që nuk e mbartin detyrimin e publikimit të raportit jo financiar sepse nuk tejkalojnë numrin 500 të të punësuarve, gjejmë se **1 (një)** njësi ekonomike e mesme dhe **3 (tre)** njësi ekonomike të mëdha e kanë publikuar atë vullnetarisht. Gjithashtu, gjejmë se **6 (gjashtë)** njësi ekonomike të mëdha (klasifikuar sipas kriterit të aktivitetit dhe të ardhurave), nuk kanë dhënë në shënimet shpjeguese informacion për numrin e të punësuarve prandaj shprehemi me rezervë nëse e kanë apo jo detyrimin për plotësimin e këtij raporti pasi nuk e gjejmë të publikuar.

➤ Raporti i drejtimit të brendshëm

Kanë detyrim ligjor për këtë raport njësitë ekonomike me interes publik. (*njësitë e mëdha ekonomike*). Ky informacion paraqitet si rubrikë më vete në raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe shprehet në lidhje me:

- i) rregullat/kodet për drejtimin e brendshëm të njësisë ekonomike, objekt i të cilave është njësia;
  - ii) rregullat/kodet për drejtimin e brendshëm të njësisë ekonomike, që njësia ka vendosur vullnetarisht të zbatojë;
  - iii) të gjitha informacionet përkatëse për praktikën e drejtimit të brendshëm të njësisë ekonomike që zbatohen përtej kërkesave të legjislacionit;
- b) një përshkrim të tipareve kryesore të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut të njësisë ekonomike lidhur me raportimin financiar;
- c) përbërjen dhe funksionimin e organeve ekzekutive drejtuese dhe mbikëqyrëse dhe të komiteteve të tyre;
- ç) një përshkrim të politikave të ndryshme të zbatuara lidhur me organet ekzekutive drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike për aspekte të tilla, si: moshë, gjinia apo prejardhja arsimore dhe profesionale, objektivat e këtyre politikave të ndryshme, si janë zbatuar dhe rezultatet për periudhën raportuese.

Nga vlerësimi i kriterëve, rezulton se në grupin e pasqyrave të monitoruara, vetëm **20 (njëzet)** njësi ekonomike të mëdha dhe **7 (shtatë)** njësi ekonomike të mesme kanë detyrimin e publikimit të këtij raporti. Rezulton që këtë detyrim e kanë përmbushur vetëm **6 (gjashtë)** njësi ekonomike: **3(tre)** njësi ekonomike të mëdha dhe **3(tre)** njësi ekonomike të mesme.

➤ Raportimi i pagesave për institucionet shtetërore

Kanë detyrim ligjor për këtë raport njësitë e mëdha ekonomike dhe ato me interes publik, që janë aktive në industrinë nxjerrëse ose shfrytëzimin për lëndë drusore të pyjeve. Ky raport përmban informacion në lidhje me pagesat që u bëhen institucioneve shtetërore në mënyrë vjetore.

- **2 (dy)** njësi ekonomike e kanë detyrim ligjor, publikimin e Raportit të pagesave për institucionet shtetërore dhe e kanë publikuar këtë raport.

- **7( shtatë)** njësi ekonomike edhe pse nuk e kanë detyrim ligjor, e kanë deklaruar paraqitur Raportin e pagesave për institucionet shtetërore.

Në mënyrë të përmbledhur, detyrimin për publikimin e raporteve që shoqërojnë pasqyrat financiare e gjejmë të përmbushur si më poshtë:

Forma Juridike	Raport i ecurisë		Raport jofinanciar		Raporti i drejtimit të brendshëm		Raportimi i pagesave për instituc	
	PO	JO	PO	JO	PO	JO	PO	JO
Njësi ekon.madhe	18	3	2	2	3	17	2	0
Njësi ekon.mesme	16	12			3	4		
Njësi ekon.vogël								
<b>Totali</b>	<b>34</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>21</b>	<b>2</b>	<b>0</b>

- Në mënyrë vullnetare, raport i ecurisë është publikuar edhe nga **2 (dy)** njësi ekonomike të vogla.
- Në mënyrë vullnetare, raport jo financiar është publikuar edhe nga **3 (tre)** njësi ekonomike të mëdha dhe **1(një)** njësi ekonomike e mesme.
- Në mënyrë vullnetare, raportimi i pagesave per institucine është publikuar edhe nga **6 (gjashtë)** njësi ekonomike të mëdha dhe **1(një)** njësi ekonomike e mesme.

### **Problematika të monitorimit të përgatitjes dhe publikimit të shënimeve shpjeguese**

Sipas ligjit Nr 25/2018 të gjitha njësitë ekonomike në shënimet shpjeguese duhet të paraqesin:

- numrin mesatar të të punësuarve gjatë periudhës raportuese  
Nga **128 (njëqind e njëzet e tetë)** njësi ekonomike që kanë publikuar pasqyrat financiare, vetëm **24 (njëzet e katër)** njësi ekonomike kanë deklaruar numrin e punonjësve;
- shumën e pagave/shpërblimeve për periudhën raportuese të anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikqyrëse (njësitë ekonomike të mesme dhe të mëdha)

Nga **49 (dyzet e nëntë)** njësi ekonomike që rezultojnë se e kanë këtë detyrim, vetëm **5 (pesë)** njësi ekonomike kanë bërë korrekt deklarimin.

Gjatë monitorimit të shënimeve shpjeguese u vërejt se jo të gjitha njësitë ekonomike kanë dhënë shpjegime të nevojshme apo të mjaftueshme për pasqyrat financiare të përgatitura sipas standardeve.

Tabela përmbledhëse – sipas klasifikimit të njësive ekonomike

Shënime shpjeguese	Madhe	Mesme	Vogël	Total njësi të monitoruara
Nuk kanë publikuar	1	8	13	22
Publikuar me mangësi	15	15	44	74
Të plota	5	5	22	32
<b>Shënime shpjeguese</b>	<b>21</b>	<b>28</b>	<b>79</b>	<b>128</b>

- **22 (njëzet e dy)** njësi ekonomike nuk kanë publikuar shënime shpjeguese ; **1 (një)** nuk ka aktivitet;
- **74 (shtatëdhjetë e katër)** njësi ekonomike nuk i kanë të plota shënimet shpjeguese;
- **32 (tridhjetë e dy)** njësi ekonomike i kanë të plota shënimet shpjeguese

Tabela përmbledhëse – sipas formës juridike të njësive ekonomike

Shënime shpjeguese	SHPK	SHA	Degë e shoqërisë së huaj	Njësi të monitoruara
Nuk kanë publikuar	18	4	0	22
Publikuar me mangësi	56	16	2	74
Të plota	21	10	1	32
<b>Total</b>	<b>95</b>	<b>30</b>	<b>3</b>	<b>128</b>

Për 74 (shtatëdhjet e katër) njësitë ekonomike që kanë publikuar shënime shpjeguese jo të plota më poshtë paraqitet një përmbledhje referuar gjetjeve për secilin prej standardeve :

Shënime shpjeguese me mangësi	PO	JO	Nuk janë shprehur fare / nuk e kanë detyrim	PO %
<b>SKK1</b>	62	12		84%
<b>SKK2</b>	68	6		92%
<b>SKK3</b>	7	62	5	9%
<b>SKK4</b>	64	9	1	86%
<b>SKK5</b>	64	10	0	86%
<b>SKK6</b>	1	0	73	1%
<b>SKK7</b>	0	11	63	0%
<b>SKK8</b>	67	7		91%
<b>SKK9</b>	1		73	1%
<b>SKK10</b>	0	2	72	0%
<b>SKK11</b>	59	15		80%
<b>SKK12</b>	65	9		88%
<b>SKK13</b>	0		74	0%
<b>SKK14</b>	2	3	69	3%

Ndër gjetjet e tjera përmendim se pjesa më e madhe e njësive ekonomike kanë probleme në lidhje me:

- SKK3 –*Instrumentet financiare*. Në shënimet shpjeguese nuk jepet asnjë informacion në lidhje me kolateralin, huanë afatgjatë p.sh, afatet, norma e interesit, maturimi, grafiku i ripagimit dhe kufizimet që instrumenti i borxhit i imponon njësisë. Po kështu nuk jepet informacion në lidhje me huatë të marra/dhëna nga/tek Ortaku.
- SKK 7- *Qiratë*. Në shënimet shpjeguese nuk jepet asnjë informacion në lidhje koston dhe vlerën kontabël të aktivitetit të marrë me qira financiare; afatet e qirasë; shpenzimet e interesit; monedhat-bazë.

- SKK 4 – *Inventarët*. Në asnjë rast nuk gjejmë që njësitë ekonomike të kenë dhënë informacion për zhvlerësim inventari, një dukuri normale në treg apo të kenë paraqitur në PASH ndonjë humbje nga zhvlerësimi i inventarëve.
- SKK 6 – *Provizionet*. Në asnjë rast, në pasqyrat financiare të hartuara sipas SKK-ve nuk kemi konstatuar që njësitë ekonomike të kenë njohur provizione (shpenzime provizionesh). Ashtu si në rastin e inventarëve, kjo tendencë për mosnjohje ndoshta lidhet me kufizimet që parashikon legjislacioni fiskal.
- SKK 5– *Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale*. Në asnjë rast, kur në pasqyrat financiare janë gjetur të ardhura nga qiratë, nuk ka informacion shpjegues nëse aktivi i dhënë me qira është klasifikuar si aktiv i investuar duke dhënë edhe gjykimin e drejtimit, të përdorur për këtë rast.
- SKK 11 – *Tatimi mbi fitimin*. Në asnjë rast nuk kemi gjetur që të aplikohet tatimi i shtyrë (aktive/detyrime tatimore). Në secilën pasqyrë të monitoruar ka rezultuar që njësitë ekonomike kanë raportuar si shpenzime tatimore vetëm vlerën e detyrimit aktual të tatim fitimit.

### ***Të tjera në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Raportimin Financiar në Shqipëri***

#### **➤ *Raportime për MFE dhe MEPJ***

Një nga detyrat funksionale të stafit të KKK-së është raportimi i vijueshëm, pranë Ministrisë përgjegjëse për financat dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për detyrat e realizuara/të planifikuara/të parashikuara, kryesisht për ato që burojnë nga detyrimi për respektimin e MSA<sup>5</sup>-së dhe PKIE<sup>6</sup>-së.

Rregullisht mbi baza tremujore, raportohet në MFE në kuadër të përgatitjes së progres raportit të Qeverisë Shqiptare në procesin e integritimit në Bashkimin European. Raportohen aktivitete, produkte, akte të miratuara të cilat janë në përputhje me PKIE dhe dëshmojnë hapa drejt harmonizimit /transpozimit të legjislacionit europian. KKK është një nga Institucionet e përfshira në plotësimin e informacionit për lidhur me Kapitullin 6 “Ligji i shoqërive tregtare” ku raportohen të gjitha aktet ligjore, nënligjore dhe të tjera në zbatim të tyre, të cilat kanë transpozuar hard dhe soft Acquis që mbulojnë çështjet e kontabilitetit dhe raportimit.

<sup>5</sup> MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

<sup>6</sup> PKIE – Plani Kombëtar për Integrimin European



Ndërsa raportimi për MEPJ kryesisht është i bazuar në adresimin e pyetjeve që vijnë për KKK-në nga negociatori. Shërbimi i Komisionit Europian është i fokusuar në plotësimin e detyrave që i janë lënë Institucioneve të vendit në Raport Progresin e përgatitur nga KE për periudhën/at e mëparshme.

### ➤ Takimi bilateral në Bruksel

Në muajin shkurt, në Bruksel u zhvillua takimi bilateral mes përfaqësuesve të Qeverisë shqiptare dhe Shërbimeve të Komisionit Europian. Takimi, në kuadër të “Screening” të legjislacionit shqiptar, kishte në fokus një prezantim të situatës në lidhje me çfarë ishte përfshirë tashmë në legjislacionin shqiptar nga Direktivat e BE, çfarë zhvillimesh ishin evidentuar lidhur me cilësinë e zbatueshmërisë së legjislacionit dhe në fund cilat ishin hapat që duhej të ndërmerrnin institucionet shqiptare për përmirësimin dhe përfundimin e procesit të transpozimit. Në prezantimin e çështjeve të kontabilitetit, Shërbimet e Komisionit Europian u informuan mbi ecurinë e përputhshmërisë së legjislacionit të kontabilitetit me Direktivën e BE për kontabilitetin. Pas raportimit, në drejtim të palës shqiptare erdhën disa pyetje, ku përveç dy prej pyetjeve, të gjitha të tjerat morën përgjigje dhe u pranuan nga Shërbimet e Komisionit. Dy pyetjet pa përgjigje shteruese ishin:

1. *Pse vijohet deri në janar 2028 të ketë një limit deri në 5 milion lekë për njësitë ekonomike, si limiti i poshtëm për raportim financiar? Direktiva nuk e parashikon një rregullim të tillë.* Pavarësisht se pala shqiptare argumentoi që kjo është një masë lehtësuese lokale nuk mori aprovimin nga Shërbimet por pati një rekomandim që ligji i kontabilitetit të bënte një ndarje të qartë mes shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe atyre të klasifikuara person fizik. Në grupin e shpk-ve nuk duhej parashikuar asnjë fasho jashtë raportimit financiar. Nënpyetje e pyetjes së parë ishte edhe çështja e OJF-ve. **Përse rregullohen OJF-të në ligjin e kontabilitetit?** Sugjeruan që raportimi financiar i OJF-ve duhej rregulluar jashtë ligjit të kontabilitetit.
2. *Përse përjashtohen PIE (ato të mesme dhe të vogla) nga detyrimi për të hartuar pasqyra financiare me SNRF? Direktiva nuk e parashikon një rregullim të tillë.* Për më tepër ngritën shqetësimin në faktin që SKKtë janë shumë më të thjeshtuara se SNRF-të dhe kjo do të konfuzonte raportimin e PIE-ve dhe vlerësimin e rezultatit të tyre financiar.

Një tjetër rekomandim që u dha në atë tryezën e Brukselit, ishte fillimi i diskutimeve në Institucionet përkatëse të procesit të implementimit të standardeve të qëndrueshmërisë, ku KKK duhej të merrte një rol të rëndësishëm.

Në mbledhjen e radhës, ku Këshilli analizoi përfundimet e takimit bilateral në Bruksel, mori angazhimin që çështjet e mbetura pezull të marrin përparësi në adresimin e tyre.

#### **4. Plani i punës për vitin 2024**

Në mbledhjen e fundit të vitit 2023, Këshilli diskutoi në parim programin e punës për vitin pasardhës 2024. Programi i hartuar synon përmbushjen e të gjitha detyrave të caktuara me ligj apo me akte të tjera nënligjore dhe përmban detyrat si më poshtë

- a)* Draftimi i një SKK të ri me fokus pagesat e bazuara në aksione;
- b)* Përkthimi i SNRF-ve dhe përgatitja e variantit të konsoliduar 2024;
- c)* Monitorimi i pasqyrave financiare të njësive ekonomike (pasqyrat të vitit 2023);
- d)* Përgatitja për botim i SKK-ve të përditësuara (2023);
- e)* Përgatitja për botim i Udhëzuesve për zbatimin e SKK-ve të përditësuara (2023);
- f)* Raportimet periodike në kuadër të Planit Kombëtar të Integritimit.

## 5. Çështje të tjera për rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të punës së KKK-së

Këshilli është një nga përfituesit e projekteve të Bankës Botërore me fokus forcimin e raportimit financiar në Shqipëri. Një nga produktet e pritshme të këtij projekti është hartimi i metodologjisë së monitorimit të pasqyrave financiare. Kjo metodologji do të udhëzojë inspektorët e KKK-së në punën e tyre të përditshme për monitorimin e pasqyrave financiare duke përzgjedhur njësitë ekonomike sipas riskut (jo përzgjedhje rastësore si bëhet aktualisht) dhe duke monitoruar treguesit material të këtyre pasqyrave. Për realizimin sa më të mirë të këtij procesi është i domosdoshëm bashkëpunimi me dy Institucionet e tjera, QKB dhe DPT si burimi kryesor për marrjen e informacionit që mundëson përzgjedhjen dhe analizën e pasqyrave të njëjësive ekonomike.

Një tjetër domosdoshmëri në Këshill është plotësimi me staf të kualifikuar në jurisprudencë pasi shumë diskutime që bëhen kërkojnë jo vetëm zgjidhjen kontabël por dhe vlerësimin e ndikimit të tyre nga pikëpamja juridike. Për këtë kërkohet mbështetje nga Ministria e Financave në hartimin e projekt akteve nënligjore për të adresuar nevojat e Këshillit për organikën dhe logjistikën.

### Shtojcë A- Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare për vitin 2023

Në bazë të Ligjit Nr. 84/2022 dhe Udhëzimin Plotësues Nr.2 datë 19.01.2023 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023”, buxheti i miratuar për vitin 2023 për KKK, paraqitet si më poshtë vijon:

Emërtimi i institucionit		Llog. Ekonomike		Plani i vitit 2023 Në lekë
1	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	600	Pagat	7.633.000
2	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	601	Sig. Shoqërore	1.327.000
3	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	602	Shpenz. Operative	5.200.000
6	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	231	Investime	1.000.000
<b>TOTALI</b>				<b>15,160,000</b>

Në zbatim të V.K.M Nr.325 datë 31.05.2023 “Miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit,

nëpunësve civilë, dhe nëpunësve të disa institucioneve të administratës publike” dhe VKM.795 datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me BE-në”, për përballimin e efekteve financiare shtesë, për shkak të rritjes së pagave, në planin e buxhetit për vitin 2023 janë miratuar këto shtesa në planin e buxhetit për vitin 2023

<b>SHTESA</b>	<b>600</b>	<b>601</b>
V.K.M nr.325 datë 31.05.2023	1,751,328	275,332
V.K.M nr.795 datë 28.12.2023	200,000	
	<b>1,951,328</b>	<b>275,332</b>

Buxheti i rishikuar dhe i miratuar për vitin 2023 për KKK, paraqitet si më poshtë vijon:

<b>Emërtimi i institucionit</b>		<b>Llog. Ekonomike</b>		<b>Buxheti i miratuar për vitin 2023 në lekë</b>
1	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	600	Pagat	9,584,328
2	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	601	Sig. Shoqërore	1,602,332
3	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	602	Shpenz. Operative	4,925,000
4	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	605	Shpenzime për transf. ndërkombetare	275,000
4	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	606	Fondi i veçantë	100,000
5	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	231	Investime	1.000.000
<b>TOTALI</b>				<b>17,486,660</b>

Shpenzimet e kryera për investime, blerje të vogla dhe shërbime të tjera për vitin 2023 të raportuar në Degën e Thesarit, Tiranë, janë si më poshtë:

<b>Përshkrimi</b>	<b>Tipi</b>	<b>Fondi i përlogaritur</b>	<b>Fondi i përdorur</b>	<b>% e realizmit</b>
Komputera, laptopë, dollapë, etj	Investime (Llog 231)	1,000,000	824,600	82.5%
<b>TOTALI</b>		<b>1,000,000</b>	<b>824,600</b>	<b>82.5%</b>

Përqindja e realizimit të shpenzimeve operative për vitin 2023, paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	Tipi	Fondi i përlogaritur	Fondi i përdorur	% e realizimit
Honorare		1,500,000	1,170,000	78.0%
Tarifa IASB, Londër	Transf. ndërkombëtare	350,000	267,632	76.5%
Shpenzime postare	Blerje nën 100.000 lekë	5,000	650	13.0%
Pastrim zyresh	Blerje nën 100.000 leke	150,000	141,000	94.0%
Kancelari	Blerje nën 100.000 leke	120,000	119,880	99.9%
Shërbim interneti	Blerje nën 100.000 leke	99,900	86,400	86.5%
Antivirus	Blerje nën 100.000 leke	60,000	25,000	41.7%
Shërbim telefoni	Blerje nën 100.000 lekë	80,000	54,555	68.2%
Shërbime, riparime, mirëmbajtje	Blerje nën 100.000 leke	200,000	61,800	30.9%
Furnizim me ujë	Blerje nën 100.000 lekë	15,000	9,816	65.4%
Furnizim me energji	Blerje nën 100.000 lekë	145,100	86,666	59.7%
Taksa lokale		15,000	15,000	100.0%
		<b>2,740,000</b>	<b>2,038,399</b>	<b>74.4%</b>

Të pa realizuara ose shumë pak të realizuara:

Përshkrimi	Tipi	Fondi i përlogaritur	Fondi i përdorur	% e realizimit
Hostim faqe interneti	Blerje nën 100.000 leke	60,000	0	0.0%
Shpenzime për aktivitete		500,000	51,120	10.2%
Përkthime IFRS		300,000	8,930	3.0%
Udhëtime dhe dieta		600,000	183,597	30.6%
Fond i veçantë		100,000	-	0.0%
Botime teksti, publikime		600,000	-	0.0%
Konsulencë juridike		300,000	-	0.0%
<b>TOTALI</b>		<b>2,460,000</b>	<b>243,647</b>	<b>9.9%</b>

Realizimi i buxhetit të shpenzimeve për paga për vitin 2023 paraqitet si vijon:

Llog. Ekonomike	Viti 2023		
	Plani	Fakti	%
Pagat 600	9,584,328	9,006,070	94%
Sigurime.shoqërore 601	1,602,332	1,449,433	90%
<b>Totali</b>	<b>11,186,660</b>	<b>10,455,503</b>	<b>93%</b>

#### Shtojcë B- Buxheti i alokuar për vitin 2024

Në bazë të Ligjit Nr. 97/2023 dhe udhëzimit plotësues Nr.2, datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, plan buxheti për vitin 2024 për KKK, paraqitet si më poshtë vijon:

Emërtimi i institucionit		Llog. Ekon		Plani i vitit 2024 në lekë
1	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	600	Pagat	10,800,000
2	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	601	Sigurime. Shoqërore	1,760,000
3	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	602	Shpenz. Operative	4,440,000
4	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	605	Transferta korrente të huaja	300,000
5	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	100,000
6	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	231	Investime	1,000,000
<b>TOTALI</b>				<b>18,400,000</b>

Plan buxheti për investime për vitin 2024 paraqitet si vijon:

Llog. Ekonomike	Viti 2024/ në lekë
	Plani
231	1.000.000
<b>Totali</b>	<b>1.000.000</b>

Sipas plan buxhetit të raportuar në Degën e Thesarit, Tiranë, totali prej **4,840,000 lekë** është detajuar për shpenzimet për blerje të vogla dhe shërbime të tjera për vitin 2024, si më poshtë:

Objekti i prokurimit	Lloji i shpenzimit	Fondi i përlogaritur
Tarifa IASB, Londër	Transfertë ndërkombëtare	300,000
Honorare		1,320,000
Shpenzime postare	Blerje nën 100.000 lekë	10,000
Pastrim zyrash	Blerje nën 100.000 leke	150,000
Kancelari	Blerje nën 100.000 leke	120,000
Shërbim interneti	Blerje nën 100.000 leke	90,000
Hostim faqe interneti	Blerje nën 100.000 leke	60,000
Antivirus	Blerje nën 100.000 leke	60,000
Shërbime, riparime, mirëmbajtje	Blerje nën 100.000 leke	200,000
Shërbim telefoni	Blerje nën 100.000 lekë	50,000
Furnizim me ujë	Blerje nën 100.000 lekë	15,000
Furnizim me energji	Blerje nën 100.000 lekë	150,000
Taksa lokale		15,000
Shpenzime për aktivitete		550,000
Përkthime IFRS		300,000
Udhëtime dhe dieta		500,000
Botime teksti, publikime		600,000
Konsulencë juridike		250,000
Shpërblim për dalje në pension		100,000
<b>TOTALI</b>		<b>4,840,000</b>

## Shtojcë C – Pasqyrat financiare 2023

Pasqyrat financiare vjetore janë ndërtuar në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr 5 datë 21.02.2022.

NJËSIA PUBLIKE		KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT	Lekë	Lekë
		PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	VITI 2023	VITI 2022
Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi Mbyllur	Ushtrimi Mbyllur
1	A	<b>A K T I V E T</b>	<b>2,679,086</b>	<b>1,840,171</b>
2		<b>I.Aktivët Afat shkurtër</b>	<b>1,029,061</b>	<b>753,031</b>
3		<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
4	531	Mjete monetare në Arkë		
5	512,56	Mjete monetare në Bankë		
6	520	Disponibilitete në Thesar	0	0
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhënie		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>49,950</b>	<b>50,400</b>
12	31	Materiale		
13	32	Inventar i imët		
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra	49,950	50,400
17	36	Kafshë në rritje e majmëri		
18	37	Gjendje të pa mbritura,ose pranë të tretëve		
19	38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
20	39	Provizione për zhvlersimin e inventarit (-)		
21		<b>3.Llogari të Arkëtushme</b>	<b>979,111</b>	<b>702,631</b>
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shëndetsore		
29	437,438,	Organizma të tjerë shtetërore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për t’u arketuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468	Debitorë të ndryshëm		
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	979,111	702,631
34	45	Mardhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		



35	49	Shuma të parashikuara për zhvleresim(-)		
36		<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes të mardhënieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për t'u shpërndare në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme		
42		<b>II.Aktivet Afat gjata</b>	<b>1,650,025</b>	<b>1,087,140</b>
43	<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>86,000</b>	<b>0</b>
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kërkime		
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e të ngjashme	86,000	0
47	<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,564,025</b>	<b>1,087,140</b>
48	210	Toka, Troje, Terene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione		
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	208,510	263,936
53	215	Mjete Transporti		
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshë pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik (vlerë e mbetur)	1,355,515	823,204
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara		
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
60	25	Huadhenie e Nënhuadhënie		
61	26	Pjesmarrje në kapitalin e vet		
62		<b>4.Investime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		
64	231	Për Aktive Afatgjata materiale (vlerë e mbetur)		
	209	Amortizimi për AAM investime		

<b>65</b>	<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>979,519</b>	<b>703,039</b>
66		<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>979,519</b>	<b>703,039</b>
67		<b>1. Llogari të Pagueshme</b>	<b>979,519</b>	<b>703,039</b>
68	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	14,366	19,947
69	42	Detyrime ndaj personelit	645,014	457,567
	421	Detyrime honorare Bordi		
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhënes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa (TAP)	97,101	65,311
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	133,186	95,654
76	436	Sigurime Shëndetsore	89,445	64,151
77	437,438,	Organizma të tjerë shtetërore		

78	44	Institucione të tjera publike		
79	45	Mardhënie midis institucioneve apo njësjive ekonomike		
80	464	Det.për t'u paguar për bl.letrave me vlerë		
81	466	Kreditorë për mjete në ruajtje		
82	467	Kreditorë të ndryshëm	407	409
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)		
84	49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
85		<b>2.Të tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
86	419	Kreditorë, Parapagime		
87	475	Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Të ardhura për t'u klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së titullit		
91		<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
92	Klase 4	Llogari të pagueshme		
93	16.17,18	Huatë Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Të tjera		

96	<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>1,699,567</b>	<b>1,137,132</b>
97	<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>1,699,567</b>	<b>1,137,132</b>
98	101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,137,132	1,257,339
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati i veprimtarise ushtrimore	562,435	-120,207
101	111	Rezerva		
102	115	Nga fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvleresime		
103	105	Teprica e granteve kapitale të Brendshme		
104	106	Teprica e granteve kapitale të Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara në përdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi i Aktiveve Afatgjata		
107		Të Tjera		
108	<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE (B+C)</b>	<b>2,679,086</b>	<b>1,840,171</b>

<b>KONTROLL E</b>	<b>Shifra 0 (Zero)- Tregon Kuadraturen</b>	<b>Kuadratura</b>	<b>Kuadratura</b>
Kontroll 1.	Aktivet Neto a jane të barabarta me Fondin e Konsoliduar	<b>0</b>	<b>0</b>
Kontroll 2.	Totali i Aktiveve a është i barabartë me = Totalin e Pasiveve	<b>0</b>	<b>0</b>

NJESIA  
PUBLIKE

**KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT**

**PASQYRA E PERFORMANCES  
FINANCIARE  
(Klasifikimi, sipas Natyres ekonomike)**

Viti 2023

Viti 2022

Lekë

Nr. rresh ti	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
a	b	c	1	2
1	A	<b>TË ARDHURAT</b>	<b>13,838,628</b>	<b>9,999,025</b>
2	70	<b>I.TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
3	700	<b>1.Tatimi mbi të Ardhurat</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
4	7000	Tatim mbi të ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogël		
7	7009	<i>Të tjera Tatime mbi të ardhurat</i>		
8	702	<b>2.Tatimi mbi Pasurinë</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
9	7020	Tatim mbi Pasurinë e paluajtshme		
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme		
11	7029	Të tjera tatime mbi Pasurinë		
12	703	<b>3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
16	7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
17	7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
18	704	<b>4.Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
19	7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
20	7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
21	7042	Tarifë shërbimi doganor e kolipostë		
22	7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
23	705	<b>5.Takse e rruges</b>		
24	708	<b>6.Të tjera Tatime e Taksa kombtare</b>		
25	709	<b>7.Gjyba e Kamat vonesa</b>		
26	75	<b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHËNDETËSORE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
27	750	NGA TË PUNËSUARIT		
28	751	NGA PUNËDHENËSI		
29	752	NGA TË VETPUNËSUARIT		
30	753	NGA FERMERET		

31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PËR SIGURIME SHOQËRORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PËR SIGURIME SHËNDETËSORE		
34	71	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	0	0
35	710	<b>1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>	0	0
36	7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare		
38	7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
39	711	<b>2.Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare</b>	0	0
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41	7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh		
42	7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
43	7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve		
44	7114	Të ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime		
46	7116	Të ardhura nga transferimi pronës,legalizimi i ndërtimeve pa leje		
47	719	<b>3.Të tjera të ardhura jo tatimore</b>		
48	76	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>	0	0
49	760	Nga interesat e huadhënies së brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhënies së Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		
52	766	Nga këmbimet valutore		
53	72	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	13,838,628	9,999,025
54	720	<b>1.Grant korent i Brendshem</b>	13,838,628	9,999,025
55	7200	Nga buxheti për NJQP(Qendrore)	12,859,516	9,296,394
56	7201	Nga buxheti për NJQP(Vendore)		
57	7202	Nga buxheti për pagesa të posacme të ISSH		
58	7203	Nga buxheti për mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale		
60	7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim i pritshëm nga buxheti	979,112	702,631
62	7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretë)		
63	7209	Të tjera grante korente të brendshme		
64	721	<b>2.Grant korent i Huaj</b>	0	0
65		Nga Qeveri të Huaja		
66		Nga Organizata Ndërkombëtare		
67		<b>VI.TË ARDHURA TË TJERA</b>	0	0
68	781	Të ardhura nga investimet në ekonomi		
69	782	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatshkurtra		
70	783	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje shumash për shpenzime të viteve ardhshme		

72	787	Tërheqje nga seksioni i investimeve		
73	73	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>		
74	<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>13,276,193</b>	<b>10,119,232</b>
75	<b>600</b>	<b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>9,250,600</b>	<b>6,553,696</b>
76	6001	Paga, personel i përhershëm	9,250,600	6,423,696
77	6002	Paga personel i përkohshëm		
78	6003	Shpërblime	0	130,000
79	6009	Shpenzime të tjera për personelin		
80	<b>601</b>	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>1,486,964</b>	<b>1,072,757</b>
81	6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	1,329,704	963,554
82	6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	157,260	109,203
83	<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>2,008,832</b>	<b>1,980,501</b>
84	602	Mallra dhe shërbime të tjera		
85	6020	Materiale zyre e të përgjithshme	25,000	22,500
	60201	Kancelari	119,880	101,102
86	6021	Materiale dhe shërbime speciale		
87	6022	<i>Shërbime nga të tretë</i>		
		Energjia	88,766	105,533
		Ujë	9,816	9,204
		Telefoni dhe internet	133,353	134,777
		Shërbime postare	570	1,013
		Shërbime bankare		
		Shërbime pastrimi	141,000	119,880
88	6023	Shpenzime transporti		
89	6024	<i>Shpenzime udhëtimi</i>		
		Udhëtime brenda vendit		
		Udhëtime jashtë vendit	183,597	331,548
90	6025	<i>Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme</i>		
		Shpenzime për mirëmbajtje zyre	60,000	0
		Shpenzime mirëmbajtje pajisje zyre	0	55,324
91	6026	Shpenzime për qeramarrje		
92	6027	Shpenzime për detyrime për kompesime legale		
93	6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua		
94	6029	<i>Shpenzime të tjera operative</i>		
		Honorare të Bordit dhe të përkthyesve	1,178,930	1,084,620
		Vulë protokollit për KKK	1,800	
		Shpenzime organizim konference	51,120	0
		Taksa vendore	15,000	15,000
95	<b>603</b>	<b>IV.SUBVECIONE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
96	6030	Subvecione për diferencë çmimi		
97	6031	Subvecione për te nxitur punësimin		
98	6032	Subvecione për të mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecione për sipërmarrjet individuale		
100	6039	Subvecione të tjera		
101		<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>267,632</b>	<b>301,171</b>

<b>102</b>	<b>604</b>	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë		
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shëndetsore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
107	<b>605</b>	<b>2.Transferime korente me jashte</b>	<b>267,632</b>	<b>301,171</b>
108	6051	Transferime për Organizatat Nderkombetare	267,632	301,171
109	6052	Transferime për Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime për institucionet jo fitimprurse të huaja		
111	6059	Transferime të tjera korrente me jashtë shtetit		
112	<b>606</b>	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
115		<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
116	<b>65</b>	<b>1.Shpenzime Financiare të brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
117	650	Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa për huamarrje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlerë Qeverisë		
120	656	Shpenz.nga këmbimet valutore		
121	<b>66</b>	<b>2.Shpenzime Financiare te jashtme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
122	660	Interesa për huamarrje nga Qeveri.të Huaja		
123	661	Interesa për financime nga Institucionet.ndërkomb		
124	662	Interesa për huamarrje të tjera jashtme		
125		<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>261,715</b>	<b>211,107</b>
126	681	Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytezimit	261,715	211,107
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, të nxjerra jashtë përdorimit e të shitura		
128	683	Shuma të parashikuara të shfrytezimit		
129	686	Shuma të parashikuara për aktivet financiare		
130	<b>63</b>	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>450</b>	<b>0</b>
131		<b>IX.SHPENZIME TË TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
132	<b>85</b>	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHËS (Rezultati i Veprimtarise së vitit Ushtrimor)</b>	<b>562,435</b>	<b>-120,207</b>

<b>KONTROLL E</b>	<b>Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen</b>	<b>Kuadratura</b>	<b>Kuadratura</b>
Kontroll 1.	Të Ardhurat a jane të barabarta me Shpenzimet + Rezultatit e vitit Ushtrimor	<b>0</b>	<b>0</b>
Kontroll 2.	Llogarja 85 e P. F2 a është e barabarte me Llog. 85 ne P. F1	<b>0</b>	<b>0</b>
Kontroll 3.	Llogarja 63 ne Pasqyren F2 a është e barabarte me Ndryshimin e Gjendjeve të Klases 3 në Pasqyren F1		

**PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE  
(CASH FLOW)**

(Sipas Metodes direkte)

Viti 2023

Viti 2022

në / lekë

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
<b>1</b>	<b>I</b>	<b>VEPRIMTARITË E SHFRYTEZIMIT</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>2</b>	<b>1</b>	<b>Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+)</b>	<b>12,737,547</b>	<b>9,878,485</b>
<b>3</b>	<b>2</b>	<b>Arkëtime e të hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>4</b>		Të hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)		
<b>5</b>		Të hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)		
<b>6</b>		Të hyra nga ardhurat jotatimore (+)		
<b>7</b>		Të hyra, sponsorizime nga të tretë(+)		
<b>8</b>		Të hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
<b>9</b>		Të hyra nga Mjetet në ruajtje(+)		
<b>10</b>		Të tjera, arkëtuar(+)		
<b>11</b>	<b>3</b>	<b>Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente</b>	<b>-12,737,547</b>	<b>-9,878,485</b>
<b>12</b>		Për detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara (-)	-702,631	-672,991
<b>13</b>		Për detyrime e shpenzime të viti ushtrimor (-)	-12,034,916	-9,205,494
<b>14</b>		Pagesat për mjetet në ruajtje (-)		
<b>15</b>		Interesi i paguar (-)		
<b>16</b>		Tatime të paguara (-)		
<b>17</b>		Të tjera të paguara (-)		
<b>18</b>	<b>II</b>	<b>VEPRIMTARITË E INVESTIMEVE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>19</b>		Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)	<b>824,600</b>	<b>90,900</b>
<b>20</b>		Të hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
<b>21</b>		Të hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
<b>22</b>		Të hyra nga interesat e huadhenies dhe nënhuadhenies(+)		
<b>23</b>		Pagesa për detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
<b>24</b>		Për detyrime e Investime të vitit ushtrimor(-)	-824,600	-90,900
<b>25</b>		Huadhenie e Nenuadhenie(-)		
<b>26</b>		Pjesmarrje në kapitalin e vet(-)		
<b>27</b>		Dividentë të paguar(-)		
<b>28</b>	<b>III</b>	<b>TRANSFERTA E TË TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>29</b>		Derdhje e Transferime të të Ardhurave në Buxhet(-)		
<b>30</b>		Transferime në buxhet të Fondeve të pa përdorura(-)		
<b>31</b>		Levizje e brendshme e transferata të tjera(+/-)		
<b>32</b>	<b>IV</b>	<b>Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>33</b>	<b>V</b>	<b>Teprica në fillim të vitit ushtrimor</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>34</b>	<b>VI</b>	<b>Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>KONTROLL</b>		<b>Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen</b>	<b>Kuadratura</b>	<b>Kuadratura</b>
Kontroll .		Teprica e Llogarise së Likuiditeve, e F3 a është e barabartë me Tepericen e Llogarive të Likuiditeteve në Pasqyren F1	<b>0</b>	<b>0</b>